



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:228282  
Datë: 10.01.2024  
Numri i dokumentit: 05174549

**C-IV-14-5237**

*Ankuesja*

**Rr D, Prishtinë.**

*Kundër*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit** (NSH “Gërmia” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” Lakrishtë nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 10 janar 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. REFUZOHET ankesa si e pabazuar.**
- 2. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN093-0057 i dates 02 qershor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- 3. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 8 korrik 2014, ankuesi parashtrroi pranë DHPGJS ankesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. PRN093-0057 i datës 02 qershor 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale ndaj N.SH “Gërmia” (në Likuidim). Ankuesi pohoi se AL ia ka refuzuar kërkesën në mungesë të provave për periudhën kohore janar 2005 deri me gusht 2007, dhe se këto vendime gjenden në arkivin e NSH-se. Ka shtuar se ka

punuar në NSH deri në vitin 2007 pastaj e njëjta i ka larguar nga puna për shkak të likuidimit dhe se i takon e drejta e asistencës sociale nga mjetet e fituara prej procesit të likuidimit. Ka shtuar po ashtu se AL nuk i ka zbatuar dispozitat e ligjit nr.04/L-034, ku precizohet dëmi që iu shkaktohet punëtorëve nga procesi i likuidimit.

Ankesës ka bashkangjitur :

- Vendimin PRN093-0057 të datës 02 qershor 2014

Me 2 dhjetor 2014 ankuesi parashtroi kërkesë për lirim nga pagesa e taksave dhe ndihme ne përkthim, duke bashkangjitur formularin dhe provat lidhur me gjendjen financiare te tij .

Gjykata ne vitin 2023 me vendimin e saj e liroj ankuesin nga pagesa e taksave gjyqësore .

Me 14 shtator 2023 gjykata dërgoi urdhrin për prova shtese , vendimin për asistencë sociale për periudhën e pretenduar .

Ankuesi ka pranuar urdhrin për prova shtese me 21 shtator 2023 por nuk ka parashtruar provat e kërkuara nga gjykata .

Me 28 dhjetor 2023 e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar ndaj ankesës, pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se kërkesa e parashtruesit është refuzuar duke u bazuar në faktet dhe bazat ligjore të nenit 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Më tutje e paditura thekson se ankesa e parashtruesit është e pa pranueshme. Pala kundërshtarë konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Ka shtuar se kërkesa do të duhej të paraqitej në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre vjetëve, nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedh nga marrëdhënia e punësimit. Në fund të përgjigjes së saj AKP thekon ankesa duhet refuzuar si e pa pranueshme dhe e pa bazuar dhe kërkon që të vërtetohet vendimi i AL-së në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr. 06/L-086.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Me vendimin PRN093-0057 të datës 02 qershor 2014 Autoriteti i Likuidimit ka kërkuar nga ankuesi vendimin e asistencës sociale të lëshuar nga NSH për periudhën janar 2005 deri gusht 2007 si dhe çdo dokument që mund të mbështesë kërkesën e tij, ankuesi përveç vendimit të vitit 2003 nuk kishte parashtruar prova tjera për të vërtetuar pretendimin e tij andaj me vendimin e datës 2 qershor 2014 është refuzuar kërkesa e tij . Ankuesi në gjykatë nuk ka parashtruar asnjë prove për të vërtetuar pretendimin e tij .

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vjen në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh mjetet për asistencë sociale. Pra , ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me periudhën dhe llogaritjen e asistencës sociale të pa paguar ashtu që ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij në tërësi.

Ankuesi nuk dorëzoi asnjë vendim për asistencë sociale përveç atij të vitit 2003 të cilin e ka parashtruar para AL, nuk parashtroi vendimin as për periudhën e pretenduar. Gjkata gjen se në mungesë të dëshmimeve, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensimin e mjeteve të asistencës sociale, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj këto prova si të tilla nuk u morën për bazë dhe e kërkesa është refuzuar si e pabazuar.

Andaj në bazë të lartë cekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi me vendimin e datës 8 dhjetor 2023 është liruar nga pagesa e taksave gjyqësore.

## **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha  
Gjyqtare